

VAKSINIMI NË PRAKTIKË

Kur ta vaksinohet fëmijën tim ?

Vaksinimi i fëmijës që në moshën 11 vjeç, garanton një efikasitet më të madh të vaksinës.

Fëmija im është në moshën :

- 11 deri 14 vjeç : vetëm dy doza janë të nevojshme ;
- nga 15 deri 26 vjeç (rikuperim) : tre doza janë të nevojshme.

Mirë ta dini: Shfrytëzohen vizitën për vaksinim për të bërë dozën përforcuese të vaksinës dTcaP*, e cila rekomandohet midis moshës 11 dhe 13 vjeç, ose vaksinën kundër meningokokut, e rekomanduar midis moshës 11 dhe 14 vjeç. Gjatë të njëjtës vizite mund të bëhet edhe një nga dozat e vaksinës kundër HPV-së.

*Vaksinë kundër difterisë (D), tetanosit (T), kollës së mirë (Ca) dhe poliomielitit (P).

Si ta vaksinohet fëmijën tim ?

Si për vajzat, ashtu edhe për djemtë, unë i drejtohem :

- një mjeku
- një farmacisti
- një mamije
- një infermjeri
- një qendër vaksinimi bashkiake ose të rrethit (informohuni pranë bashkisë tuaj ose pranë këshillit të rrethit).

Cilat mund të jenë efektet anësore ?

Efektet anësore që janë vërejtur më shpesh gjatë studimeve klinike janë të njëjta me ato të vaksinave të tjera : reaksione lokale në vendin e injektimit (shquqje, dhimbje dhe/ose ënjtje), dhimbje koke, marramendje ose temperaturë dhe, më rrallë, reaksione alergjike ose gjendje të fikëti me mundësi humbjeje të vetëdijes.

Këto efekte anësore janë zakonisht të lehta ose mesatare për nga intensiteti dhe zgjasin për një periudhë të shkurtër.

Sa kushton vaksinimi kundër HPV ?

- Çdo dozë e vaksinës mbulohet në masën 65 % nga fondi juaj i sigurimit shëndetësor. Pjesa e mbetur zakonisht rimbursohet nga sigurimet shëndetësore plotësuese (mutualet etj.).
- Vaksinimi mund të jetë falas në disa qendra vaksinimi, komunale ose të rrethit.
- Për personat që përfitojnë nga Sigurimi Shëndetësor Plotësues Solidar (CSS) dhe nga Ndhima Mjekësore Shtetërore (AME), nuk ka asnjë pagesë për të bërë.

NJË VAKSINIM I SIGURT DHE EFIKAS PËR TË MBROJTUR FËMIJËN TIM KUNDËR KANCERËVE HPV.

FËMIJA JUAJ ËSHTË I REGJISTRUAR NË KLASËN E 5-TË, ME AUTORIZIMIN TUAJ :

- mund të vaksinohet në shkollën e mesme nga një profesionist i shëndetit;
- do të marrë dy doza të vaksinës, me një interval prej 5 deri 13 muajsh midis tyre.
- ju nuk do të keni asnjë pagesë për të bërë.

vaksinimi kundër HPV-së mund të kombinohet me vaksinimin kundër meningokokut, i cili gjithashtu është falas në shkollën e mesme.

Deri më sot, **më shumë se 100 milionë** fëmijë dhe adoleshentë janë vaksinuar në rreth 80 vende.

Për të mësuar më shumë,
flisni me profesionistin tuaj të shëndetit
ose vizitoni **vaccination-hpv.cancer.fr**



VAKSINIMI KUNDËR KANCEREVE HPV*

TË MBROJMË
VAJZAT DHE
DJEMTË QË
NGA MOSHA
11 VJEÇ.

UDHËZUES
PRAKTIK

*HPV : Human Papillomavirus ose Papilomavirus Njerëzor.

INFORMOHUNI PËR VAKSINIMIN KUNDËR KANCERËVE TË LIDHUR ME HPV-NË

Pse duhet të vaksinohet fëmija im ?

Sot, vaksinimi kundër HPV-së parandalon deri në 90 % të infeksioneve me HPV që shkaktojnë kancer.

Ai rekomandohet si për vajzat, ashtu edhe për djemtë, për mbrojtje kundër:

- lezioneve parakanceroze dhe/ose kancerit të qafës së mitrës, vulvës, vaginës dhe anusit;
- lezioneve beninje, por të dhimbshme, që shfaqen në lëkurë ose në mukozën e anusit dhe të zonës gjenitale (lythat anogjenitalë).

NJË VAKSINIM I SIGURT DHE EFIKAS

Prej më shumë se 15 vitesh, janë lëshuar më shumë se 300 milionë doza në mbarë botën.

Një mbikëqyrje ndërkombëtare e rreptë.

Përdorimi i gjerë i vaksinave kundër HPV-së, sistemet e monitorimit të vendosura në shumë vende dhe në nivel ndërkombëtar, si edhe rezultatet e studimeve të posaçme, kanë konfirmuar profilin e tyre të shkëlqyer të sigurisë, i cili njihet edhe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH)

Për shembull, nuk është vërtetuar asnjë lidhje midis këtyre vaksinave dhe sëmundjeve autoimune. Efektiviteti i vaksinimit kundër HPV-së është vërtetuar në vendet ku përqindja e të rinjve të vaksinuar është e lartë, si në Australi, ku është vërejtur një ulje e rasteve të kancerit dhe të lezioneve parakanceroze të qafës së mitrës, si edhe e lythave anogjenitalë te burrat dhe gratë.

INFORMOHUNI PËR PAPILOMAVIRUSET NJERËZORE (HPV)

Ç’janë HPV-të ?

HPV-të janë viruse njerëzore të quajtura papillomaviruse. 80 % e grave dhe burrave ekspozohen ndaj këtyre viruseve gjatë jetës së tyre. Infeksionet nga HPV-ja zakonisht zhduken brenda disa muajsh, por një pjesë e vogël mund të vazhdojë të qëndrojë dhe të kthehet në sëmundje.

Ç’ lidhje ka midis viruseve HPV dhe kancereve ?

Ekzistojnë rreth 200 lloje të HPV-ve, disa prej të cilëve janë shkaktarë të lezioneve parakanceroze dhe të kancereve. HPV-të janë gjithashtu shkaktarë të lythat anogjenitalë.

Si transmetohen viruset HPV ?

Këto viruse transmetohen përmes kontaktit të thjeshtë në zonën gjenitale, më shpesh gjatë marrëdhënieve seksuale, me ose pa penetrim.

ÇDO VIT, NË FRANCË, 7 130 RASTE TË REJA KANCERI SHKAKTOHEN NGA PAPILOMAVIRUSET NJERËZORE

Edhe pse kanceret e lidhura me HPV-në prekin në shumicën e rasteve gratë, rreth 30 % e tyre prekin burrat.

Numri i sëmundjeve të shkaktuara nga HPV-ja te gratë dhe burrat në Francë (sipas regjistrave të kancereve, 2018, për kanceret dhe sipas Shield et al., Hartwing et al., 2015, për lezionet parakanceroze dhe lythat anogjenitalë).

	BURRA	GRA
Kanceret e penisit / Kanceret e vulvës dhe të vaginës	120	250
Kanceret e anusit	450	1 400
Kanceret e orofaringut, të laringut dhe të zgavrës së gojës	1530	480
Kanceret e qafës së mitrës	—	2 900
Lezionet parakanceroze të vulvës, të vaginës, të anusit	130	rreth 2 500 - 3 000
Lezionet parakanceroze të qafës së mitrës (CIN 2+)	—	rreth 30 000
Lythat anogjenitalë	rreth 50 000	rreth 50 000